

31.12.2025

Procesverbal - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Mirëmbajtje riparime nga të tretët avolzhime”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime per riparimin dhe mirembajtjen e pompave 50511000-0

Vlera e fondit limit: 1.971.667 (nje milion e nenteqind e shtatedhete e nje mije e gjashteqind e gjashtedhete e shtate) Lekë, pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 ;përkatësisht në vlerën përkatësisht në vlerën 39.433,3 (tridhjetë e nente mije e katerqind e tridhjetë e tre presje tre) lekë

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.

”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime).

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe

përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit .

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

3.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

a.1(një)Inxhinier elektrik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në sistemin e prokurimeve elektronike:

a)Kontratë pune

b)diplomën përkatëse

3.1.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **3 punonjësish ku të jetë përfshirë dhe inxhinieri elektrik.**

3.2.Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Shtator 2025- Nentor 2025**

3.4 Pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shtator 2025- Nentor 2025.**

Shënim: Për pikat 3.1 dhe 3.2 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin

formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë prane AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lidhur mbi disponimin e 1(një) inxhinieri elektrik është i nevojshëm me qëllim realizimin e shërbimit të avolzhimit të pajisjeve elektromotor dhe transformator.

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e e preventivit të shërbimeve.

4.Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose qera makineritë dhe pajisjet e mëposhtme:

- Bango për montimin e nukleve të transformatorëve
- Bobinatrice për avolzhim motorësh
- Filtër presë për pastrimin e vajit të transformatorëve
- Filtër vakum për pastrimin kimik të vajit të transformatorëve
- Furrë elektrike e montuar në fabrikë
- Makineri për përpunim teli
- Mjet ngritës pirun
- Pajisje saldimi
- Tranxh mekanike
- Trapano
- Tronkatriçe për prerjen e nukleve 45 gradë

Për të vërtetuar këtë, mjetet duhet të shoqërohen me dokumentat e mëposhtme:

Kur janë në pronësi duhet të shoqërohen me faturë TVSH ose deklaratë zhdoganimi, ose cdo lloj forme të parashikuar nga Kodi Civil.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerasë me afat jo më të vogël se sa afati i kryerjes së shërbimit shoqëruar me dokumentat e mjeteve me faturë TVSH ose deklaratë zhdoganimi, ose cdo lloj forme të parashikuar nga Kodi Civil.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes se kontrates, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

- Bango për montimin e nukleve të transformatorëve shërben për të gjitha punimet dhe riparimet që bëhen në transformator. Duke mos pasur bango pune gjatë punimeve mund të thithen apo të ngjiten pluhura në nuklin apo pështjellat e transformatorit gjë e cila do të conte në uljen e izolimit të vajit dhe për pasojë djegien e transformatorit.
- Bobinatriçe për avolzhim motorësh është e domosdoshme pasi të gjitha riparime elektrike të transformatorëve apo elektromotorëve konsistojnë në zëvendësimin e bobinave.
- Filtër presë për pastrimin e vajit të transformatorëve dhe filtër vakum për pastrimin kimik të vajit të transformatorëve shërben për rikuperuar vajin e transformatorëve i cili nuk ka humbur plotësisht cilësitë izoluese.
- Furrë elektrike e montuar në fabrikë e cila shërben për tharjen e llakut me të cilin lyhen të gjitha bobinat e zëvendësuar.
- Makineri për përpunim teli shërbejnë për përpunimin e telit i cili do të përdoret për të bërë bobinat e elektromotorëve dhe transformatorëve.
- Mjet ngritës pirun është parë e domosdoshme në kyerjen e shërbimit pasi shumë nga pajisjet që UKT sh.a duhet të riparoj janë shumë të rënda dhe për spostimin e tyre në repartet e ndryshme ku bëhet riparimi, ndaj piruni shërben për spostimin e pajisjeve.
- Pajisje saldimi janë të domosdoshme për të salduar pjesë të ndryshme metalike të cilat mund të jenë dëmtuar gjatë punës.
- Tranxh mekanike shërbejnë për prerjen e fletëve elektroteknike të nuklit të transformatorëve të cilat mund të jenë dëmtuar gjatë punës.
- Trapano është një pajisje e domosdoshme në të gjitha proceset e punës të riparimeve.
- Tronkatriçe për prerjen e nukleve 45 gradë shërben për nuklet të vecanta transformatori të cilët kanë kënde 45 gradë në konfiguracionin e tyre.
-

II. ARGUMENTIM

MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE TË

“Mirëmbajtje riparime nga te tretët avolzhime”.

Kërkesat teknike për riparimin e elektromotorëve

1. Teli për avullgimin e motorit

Teli duhet të jetë prej bakri të emaluar, me izolim të klas F, sipas standardit IEC 60216.

2. Materialet izoluese

Materialet izoluese dhe Ilaku izolues të jenë klas F, sipas IEC 60085

3. Tharja pas pështjelljes

Pas përfundimit të pështjelljes, elektromotori duhet të thahet në furrë në temperaturë 95°C.

4. Lidhjet elektrike

Të gjitha lidhjet duhet të jenë të forta dhe pa oksidim, sipas IEC 60947 për lidhjet elektrike.

5. Pjesët këmbimi

Pjesët dhe aksesoret duhet të jenë të certifikuar dhe të perputhen me specifikimet e motorit, sipas ISO 9001 për cilësinë e prodhuesit.

6. Lubrifikimi i pjesëve lëvizëse

Lubrifikimi të kryhet sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe standardit ISO 12925.

Testet që kryhen pas montimit

1. Prova e matjes së rezistencës së pështjelljeve

2. Prova e matjes së rezistencës së izolimit

3. Prova e simetrisë së rymave (asimetri $\leq 3\%$)

4. Prova me tension të aplikuar ($2 \times U_n$)

5. Prova me frekuencë të ritur për izolimin ndër-faza

6. Matja e humbjes së motorit sipas metodës me 8 (delta)

7. Balancimi i rotorit (30% mbi shpejtësinë nominale)

8. Prova e fërkimit në ngarkesë

9. Prova e lidjes së shkurtër

10. Kontrolli i vibracioneve

11. Testi i temperaturës në ngarkesë

12. Kontrolli i sigurtisë mekanike

Të gjitha testet duhet të kryhen sipas standardeve IEC 60034 për elektromotorët elektrikë.

Prova e Garancisë së Punimeve

Garanci minimale 12 muaj për punimet dhe materialet (tela, materiale izoluese, llak, montim).
Çdo defekt teknik i evidentuar nga Autoriteti Kontraktor riparohet pa kosto brenda 48 orëve.
Garancia fillon nga data e pranimit dhe vënies në punë të elektromotorit.